



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.234/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa A.nr.234/2025 e datës 28.01.2025, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025

A r s y e t i m

Me datë 28.01.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.234/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 27.01.2025, banor të Prishtinës kanë fotografuar dhe realizuar video dhe gjithashtu kanë raportuar në selinë kryesore të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka shpërndarë njoftime për mbajtjen e tubimit, në banesat e ndërtesave me banim kolektiv në lagjen “ Kodra e Diellit” në hyrjet nr.39 dhe nr.48 në Rr.” Hyzri Talla” në Komunën e Prishtinës. Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Si provë ka bashkangjitur, CD me video incizim nga ndërtesa në Rr. “Hyzri Talla” dhe fotografit që dëshmon shpërndarjen e njoftimeve pranë dyerve të banesës në ndërtesat nr.39 dhe nr.48 në Prishtinë.

Më datë 28.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizjen Vetëvendosje, me seli në Prishtinë për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje, mirëpo Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk është përgjigjur as në afatin e paraparë deri më datë: 29.01.2025.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se Subjekti Politik e Lëvizja Vetëvendosje, ka shpërndarë material zgjedhor/njoftime brenda ndërtesave publike apo godinave për tubimin politik janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton” Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim, paragrafi 2.2 vendosa e njoftimeve, pllakateve dhe postëreve , ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, ne shenjat e trafikut publik, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna, ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizata ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”, pasi që në fotografitë e bashkangjitura në ankesë shihen vetëm disa njoftime të shpërndara në hyrje të banesave por që nuk është e vërtetuar se nga kush janë shpërndarë këto fletushka, njëherit edhe nga CD-ja e bashkangjitur nuk shihet se kush i ka shpërndarë fletushkat në fjalë .

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe pretendimet e palës ankuese paneli vlerësoi se pretendimi ankimor për shpërndarjen e njoftimeve brenda ndërtesave për tubim publik janë të paqëndrueshme dhe si të tilla Paneli i refuzoi për faktin se subjekti politik PDK nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi , nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime janë ndërmarr nga subjekti politik kundër të cilit është paraqitur ankesa, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të Nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe sipas Rregullës NR.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, neni 5, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3 ankesat që dorëzohen në PZAP për shqyrtim duhet të përmbajnë këto të dhëna:1.3.Kohën, datën dhe orën kur ka ndodhur shkelja, ku në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk ka dhënë hollësi që të dihet se ku janë shpërndarë këto njoftime, në cilën datë ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe nga provat e ofruara nuk mund te identifikohet objekti se ku ka ndodhur shpërndarja e materialeve zgjedhore andaj ne prani te këtyre rrethanave ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor në hapësira të palejuara konkretisht në ndërtesa, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.234/2021 më datën 30.01.2024



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.